



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA III

Sesioni IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 01 .

Prishtinë, më 21.03.2011

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Saša Rašić, Myzejene Selmani, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Agim Kuleta, Jasmina Živković, Jelena Bontić, Petar Miletić, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi .

Nga pjesëmarrësit e tjerë: përfaqësues nga OSB-ja Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësuesit nga KDI Besnik Ramadanaj, Kastriot Shala, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Saša Rašić, kryetari i Komisionit.

1. Mbledhja Konstituive

Saša Rašić – e hapi mbledhjen e komisionit duke shprehur gatishmëri dhe vullnet të mirë që do të kryeson komisionit në këtë përbërje.

Vlerësoi se privilegj e komisionit është që të jetë sa më konstruktivë në shqyrtimin dhe miratimin e të gjitha ligjeve dhe vendimeve me të cilat garantohen të drejtat dhe interesat e komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Duke pasur parasysh se Kosova ka para vetës shumë sfida, një ndër to është çështja e kthimit, andaj komisioni do të jetë sa më konstruktivë në zgjedhjen e çështjeve me prioritet.

Kryesuesi- për prezantim fjalën iu dha anëtarëve tjerë të komisionit.

Myzejene Salmanaj- tha se Kuvendi i Republikës së Kosovës funksionon në bazë të punës që zhvillohet në komisione. Meqë për herë të parë punon në këtë komision, ajo theksoi se do të kontribuojë në të gjitha çështjet në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të qytetarëve që jetojnë në Kosovë.

Sa i përket planit të punës, ajo propozoi që më parë të pres miratimin e Strategjinë Legjislative të Qeverisë dhe më pas kryetari me nënkryetarët të hartojë një plan të punës për periudhën e këtij sesioni i cili do të jetë në harmonizim me legjislacionin.

Rasim Demiri, tha se Partia Demokratike e Boshnjakëve ka dërguar shkresë me shkrim për korrigjimin e formularit për regjistrim.

Lidhur me përmbajtjen e shkresën, është bërë një lëshim ku në listë për regjistrim figuron fjala ‘ boshnjake’ ndërsa duhet të zëvendësohet me fjalën bosanski.

Kryesuesi- tha se kërkesa e parafolësit, nuk është caktuar në rend dite për sot, dha sqarim që pasi të kryhen procedurat teknike e njëjta do të caktohet për shqyrtim në mbledhje të radhës.

Petar Miletic-, tha se në mandatin e kaluar, një vit e ka kryesuar këtë komision. Vlerësoi se komisioni është i një rëndësie të veçantë ku bashkërisht do të shqyrtojmë të gjitha ligjet të cilat vijnë nga Qeveria dhe do të harmonizojmë edhe çështjet tjera të rëndësishme. Propozoi që komisioni në bashkëpunim me administratën që mbështet komisionin, të hartojë një plan të punës për aktivitetet legjislative për periudhën një vjeçare.

Jasmina Zivkovic- pas prezantimit të saj diskutoi lidhur me planin e punës dhe propozoi që kryetari në bashkëpunim me nënkryetarët e komisionit duhet ta paraqet draft planin e punës në mbledhje të radhës dhe më pas komisioni do të shqyrtojë, nëse ka nevojë do të modifikojë ndryshimet eventuale.

Lumnije Morina – tha se në tri mandate ka qen anëtare e Kuvendit Komunal në Ferizaj, dhe se në njërin mandat ka qen anëtare për komunitete andaj kjo përvojë do të jetë mekanizëm për kontributin e saj në komision. Pajtohet me parafolësen që më parë të shqyrtohet Strategjia Legjislative dhe më pas komisioni të hartojmë planin e punës.

Myfera Sinik, e përkrahën propozimin që më parë të shqyrtohet Strategjia Legjislative dhe më pas komisioni të hartojmë planin e punës.

Albert Kinolli- tha se do të jetë konstruktiv dhe se e përkrah propozimin e marr nga ana e komisionit

Agim Kuleta – tha se bashkërisht do jemi konstruktiv në funksionalizimin dhe realizimit e detyrave që bartë ky komision. Shtoi se komunitetet janë çështje njerëzore dhe në këtë drejtim do të ofrojmë maksimumin në shqyrtimin e të gjitha çështjeve të cilat do ta ndihmojë atë në nivelin Parlamentar.

Lirije Kajtazi – njoftoi se nga angazhimeve të saja bartë një përvojë, një mandat ka punuar si zëvendës kryetare në komunën e Gjilanit ku ka bashkëpunuar me ekipin për komunitete. Shtoi se bashkërisht do të kontribuojë për një mirëqenie të mirëfilltë të të gjitha komuniteteve.

Jelena Botic –tha se me rëndësi për komision është bashkëpunimi institucional në gjitha sferat e fushëveprimtarisë për çështjet e komuniteteve në ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të saja.

Kryesuesi - tha se Komisioni veprimtarinë do ta ushtrojë duke u mbështetur në miratimin e Strategjisë Legjislative të Qeverisë. Më pas komisioni do të hartojë Planin e punës periodike për vitin 2011.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Saša Rašić